



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Opština Drenas –Municipality of Drenas
Zyra e Kuvendit

REPUBLIKA E KOSOVËS			
KOMUNA GLLOGOC			
GLLOGOC MUNICIPALITY			
PRANUAR		25.09	2023
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
02-060/06		48002	



Raporti nga procesi i organizimit të dëgjimeve buxhetore për projekt-buxhetin e komunës për vitin 2024

Shtator, 2023

Hyrje

Buxheti i Komunës së Drenasit për vitin 2024 është 20,968,992 euro. Komuna vazhdon të dominohet në buxhetin total të saj nga transferet qeveritare të cilat edhe në tri vitet e ardhshme (2023-2025) do të përbëjnë afërsisht **92.56%** të buxhetit total të komunës, edhe pse në vitet paraprake pjesëmarrja e grandeve në buxhet ka qenë përafërsisht **92.31%**. Të Hyrat Vetanake mesatarisht planifikohet të marrin pjesë në buxhet me **7.44%**, prej tyre të hyrat tatimore me **60.08%**; ndërsa ato jo tatimore marrin pjesë më **39.92%**. Vlen të ceket se kufijtë e të hyrave sipas burimeve të financimit të buxhetit komunal janë caktuar me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2024-2026, lëshuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Maj/2023. Planifikimi i buxhetit komunal ndër vite pritet të ketë një rritje mesatare prej **5.46%**.

Duke u bazuar në Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësit, Statutit të Komunës së Drenasit, si dhe nenit 6 pika 1.3 Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, Qarkores 01/23 dhe Qarkores 02/23 të Ministrisë së Financave, Grupi Punës në koordinim me kryetarin e Komunës së Drenasit, z. Ramiz Lladrovci si dhe Zyrën për Komunikim me Publikun, kanë bërë të gjitha përgatitjet e nevojshme për organizimin e dëgjimeve buxhetore publike me qytetarë për përgatitjen e buxhetit për vitin 2024.

Përgatitja e raportit është bërë duke u bazuar edhe në nenin 9 pika 2 e Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna. Në këtë raport mund të gjeni të dhëna që nga mbajtja e dëgjimit publik dhe mënyra e marrjes së kërkesës nga ana e qytetarëve (formë fizike, elektronike dhe në takimin direkt të mbajtur në lokalitet).

Me qëllim të informimit të qytetarëve për mundësit buxhetore dhe planifikimet paraprake të ndarjeve buxhetore në projekt buxhetin e komunës për vitin 2024, Grupi Punës në koordinim me drejtorin për buxhet dhe financa ka përgatitur një dokument të veçantë me informata të përgjithshme për projekt buxhetin e vitit 2024 duke përfshirë edhe ndarjet fillestare buxhetore të planifikuara. Ky dokument është shpërndarë në kopje fizike për të pranishmit-pjesëmarrës në dëgjimet buxhetore.

Ecuria e procesit të dëgjimeve buxhetore për projekt buxhetin e vitit 2024

Shyqri Bublatku (kryesues), Milaim Hajdari – kryesues i kuvendit, Kushtrimi Bajrakatari – ZKF, Lumnije Krapë – Drejtoresh e Shërbime Publike dhe Emergjencë, Anita Avdullahu – Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, Flutra Avdiu¹ -Drejtorja për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit, Agnesë Kastrati – Buxolli – Drejtoria për Zhvillim Ekonomik, Laureta Thaqi – Drejtoria e Adminsitrateës, Enkela Dema – Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, Muhamet Gjoka – Drejtoria Komunale e Arsimit, Endrit Gllareve – Drejtoria e Infrastrukturës Publike, Enver Hoxha – Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Bekim Dobra – Zyra për Informim, Lumturije Kiqina – Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenies Sociale si dhe Avdyl Mziu – Zyra e Kryetarit,.

Procesi i hartimit të projekt buxhetit të viti 2024 i ka parapri miratimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) 2024-2026. Grupi Punues në bashkëpunim me ekzekutivin e komunës si dhe Komitetin për Politikë dhe Financa (KPF), para miratimit të këtij dokumenti strategjik nga ana e Kuvendit të Komunës, ka organizuar një dëgjim buxhetor me qytetarë. Procesverbali nga organizimi i dëgjimit buxhetor, në pajtim me kërkesave ligjore është publikuar në ueb faqen e komunës.

Në suaza të ecurisë dhe planifikimit sa më të mirë të dëgjimeve buxhetore, Grupi Punues ka hartuar Planin e Brendshëm të Veprimit të organizmit të dëgjimeve buxhetore 2024, ku janë specifikuar obligimet ndërinstitucional me qëllim të organizmit sa më të mirë të dëgjimeve buxhetore. Në këtë kontekst, është përpiluar edhe kalendari për mbajtjen e dëgjimeve buxhetore, ku si i tillë është përcjellë edhe me ftesat publike dhe informimi në kohë për ndryshimet që kanë ndodhur gjatë procesit të organizimit të dëgjimeve buxhetore. Ftesat dhe informatat për organizimin e dëgjimeve buxhetore janë publikuar në ueb faqen e komunës si dhe në mekanizma tjerë alternativ të tilla si: platformën e konsultimeve publike të nivelit qendror si dhe rrjetin social facebook: <https://www.facebook.com/komunadrenas/posts/pfbid02EBYR9v7HFTdjtAiZpht4hEëtM8Dr8P3ëiRLuATnxokEëqnfAKAJkkuykXkz2c3R2Zl>

<https://kk.rks-gov.net/glllogoc/category/degjime-buxhetore/?fbclid=IëAR3fySDRz92SBJN4CRDPLrM9qvQssNjAqUmBBDF8Ejqkb-6aJYLCpkOpLs8>

<https://konsultimet.rks-gov.net/consultationsList.php>

¹ Pjesë e grupit punues deri në largim nga detyra zyrtare, për tu zëvendësuar nga Petrit Gashi.

Krahas planifikimit të dëgjimeve buxhetore me prezencë fizike, komuna e Drenasit ka synuar që projekt buxheti i vitit 2024 të jetë në konsultim edhe përmes formave elektronike, duke dhënë mundësi qytetarëve të kenë qasje në këto dokumente. Për më tepër, Qarkorja Buxhetore 01 dhe Qarkorja Buxhetore 02, janë publikuar në ueb faqen e komunës si dhe në platformën e konsultimeve në nivel qendror.

<https://kk.rks-gov.net/gllogoc/ep-content/uploads/sites/10/2023/09/Buxheti-i-Komunes-per-vitin-2024-dhe-Parashikimi-i-buxhetiti-2025-2026.pdf>

Njoftimet për mbajtjen e dëgjimeve buxhetore publike me qytetarë janë publikuar brenda afateve ligjore në uebfaqen zyrtare të komunës, platformën e konsultimeve publike dhe në rrjetin social facebook. Në fund të secilit njoftim janë publikuar emailat e zyrtarëve ku qytetarët kanë pasur mundësi ti dërgojnë kërkesat, sugjerimet e tyre. Njoftimet e publikuara në uebfaqe dhe në platformën e konsultimeve publike:

Ueb faqja zyrtare e komunës:

<https://kk.rks-gov.net/gllogoc/category/degjime-buxhetore/>

Platforma e Konsultimeve publike:

<https://konsultimet.rks-gov.net/meetingsList.php>

Emailët zyrtarë për kërkesat, komentet dhe sugjerimet e qytetarëve: Shyqiri.bublaku@rks-gov.net, komuna.drenas@rks-gov.net, bekim.dobra@rks-gov.net,

Grupi punues, në kuadër të ndarjes së përgjegjësiive dhe ndërmarrjes së aktiviteteve për rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në procesin e konsultimit publik për projekt buxhetin e komunës, kishte planifikuar shfytëzimin e databazës së konsultimeve publike për të targetuar grupe të ndryshme qytetare dhe përfshirjen së tyre në proces të konsultimeve publike. Në këtë kontekst, grupi punues përmes Zyrës për Informim, përmes komunikimeve elektronike ka dërguar rreth 350 ftesa të personalizuar për grupe të ndryshme qytetare përfshirë: OJQ, biznese, fermerët, ekzpert të fushave të ndryshme, drejtor të shkollave, përfaqësues të organizatave rinore, organizatave studentore, anëtarëve të KKS-së, anëtarëve të kuvendit të komunës etj ku kryesisht është shfrytëzuar data baza e Komunës së Drenasit.

Metodat e konsultimit	Data / Kohëzgjatja	Numri i pjesëmarrësve	Numri i atyre që kanë dhënë komente, kërkesa / sugjerime	Ndarja gjinore
Dëgjim Publik i Përgjithshëm me qytetarët e Komunës së Drenasit, i organizuar nga Komiteti për politikë dhe Financa.	15.09.2023, 2 orë	39 pjesëmarrës	6 pjesëmarrës kanë parashtruar kërkesa	22 M 17 F
Publikimi në ueb faqe / platforma elektronike . https://kk.rks-gov.net/gllogoc/wp-content/uploads/sites/10/2023/09/Njoftim-Publik.pdf	7 ditë	39 pjesëmarrës	6 pjesëmarrës kanë parashtruar kërkesë për projeksionet buxhetore	

Të gjitha kërkesat e parashtruara në takimet fizike si dhe ato në formë elektronike, janë shqyrtuar nga Grupi Punues, ndërsa raporti i detajuar për kërkesat e pranuar apo refuzuara, është paraqitur në formë të plotë në shtojcën nr. 1 të këtij raporti.

Projekt buxheti i vitit 2023, pas përmbylljes së procesit të dëgjimeve buxhetore, do të finalizohet dhe deri më **1 tetor 2023** do të procedohet për në kuvendin e Komunës së Drenasit.

Shtojca 1 - Tabela e detajuar me informatat për kërkesat e dhëna, arsyetimet për kërkesat e pranuar dhe të refuzuara.

Temat e dëgjimit buxhetor	Kërkesat / Sugjerimet / Komentet	Kush ka dhënë kërkesë / sugjerim për projekt buxhetin e vitit 2023	Statusi i kërkesës / sugjerimi (i pranuar , pjesërisht e pranuar apo nuk është pranuar	Arsyetimi (komentimi për pranimin pjesërisht dhe mos pranimit të komenteve është i detyrueshëm)
Projekt buxheti i vitit 2023	Kërkesë për realizimin e projektit ndriçimit publik dhe ndërtimi i çerdhes.	Habib Gashi, Administrator i fshatit Nekoc	Pjesërisht e pranuar E refuzuar	Grupi punues pas shqyrtimit dhe analizimit të kërkesës, mbi bazën e mundësive buxhetore dhe shpërndarjes së buxhetit në mënyrë sa më racionale, ka marrë për bazë dhe ka inkorporuar pjesërisht kërkesën e tillë në projeksionet buxhetore të vitit 2023, përkatësisht realizimin e projektit të ndriçimit publik në fshatin Nekoc do të përfundoj. Sa i përket ndërtimit të çerdhes, ju kemi njoftuar edhe më herët që nuk mund ta bëjmë sepse nuk na lejohej numri i të punësuarve prandaj nuk mund ta realizojmë. Natyrisht se kërkesa juaj është legjitime mirëpo neve nuk na lejon ligji sepse nuk kemi të drejt ta rrisim numrin e të punësuarve në arsim.

	Kërkesë për realizimin e projektit të ndriçimit publik dhe kanalizimit.	Samedin Kiqina, Administrator i fshatit Baicë	Pjesërisht e pranuar	Sa i përket kanalizimeve të ujërave të zeza nuk ka fshat në Komunën e Drenasit që kemi punuar më shumë se në fshatin Baicë, jemi para përfundimit, sa i përket dritave ne kemi bërë kërkesa në KEDS që me i vendos orët matëse në fshatin tuaj.
	Propozim për subvencionim për lehonat në Komunën e Drenasit, dhe kërkesa tjetër është Subvencionimi i familjeve me kushte jo të mira ekonomike që i dërgojnë fëmijët në kopshte private në mënyrë që tu lehtësohet grave në tregun e punës.	Florentina Elezi-Veliu, Asambliste	E refuzuar	Sa i përket subvencionim të lehonave kur një institucion tjetër subvencionon lehonat nuk munden me pas subvencionim të dytë nga i njëjti buxhet i shtetit, janë kërkesa të nevojshme dhe të arsyeshme mirëpo qeveria e ka marrë përgjegjësi për këtë çështje.
	Në Poklek të Vjetër kërkojmë furnizimin me ujë të pijes, ndriçimin i rrugëve në Poklek dhe Vasilevë, firmat që i	Zekë Kluna, Administrator i fshatit Poklek i Vjetër, Poklek i Ri dhe Vasilevë	E pranuar	Drejtoria e Infrastrukturës Publike : Ndriçimi publike do te vendoset në të gjitha fshatrat, në fshatin Poklek i Ri ka përfunduar në 90% në fshatin Poklek i Vjetër kanë mbetur disa rrugica të vogla që brenda vitit 2024 do të përfundohen si dhe në fshatin Vasilevë do ketë investime të reja në

	kanë kryer disa punime në rrugë gypat janë prish tek shkolla në Poklek dhe tek lumi "Drenica". Një gropë septike me e mbyll kërkoj me marrë masa sa i përket kësaj çështje. Dhe kërkesë tjetër rregullimi i një parku të vogël tek ujti i thartë. Ndërtimi i një fushe sportive tek Banesat e reja në Poklek të Ri.		E refuzuar	ndriçimin publik. Demolimi i gropës septike do të kryhet brenda viti 2024 si proces i punimeve duhet të parashihet në projektin e vitit 2024. Përgjigja: Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë: Zyrtaret e DShPE-së, me datë 21.09.2023 kanë pranuar të njëjtën kërkesë me Nr. 13-070/01-47602 dhe menjëherë kemi udhëzuar Operatorin Ekonomik për hapjen e pusëtës. Përgjigja: Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport: Meqenëse kërkesa është bërë në gjatë dëgjimeve buxhetore këtë vit Fusha Sportive në Poklek i ri nuk është në listën e Planeve Buxhetore të këtij viti kalendarik paraprak e cila zhvillohet këtë vit, megjithatë do të kemi parasysh kërkesën e administratorit të Poklekut të vjetër për fushën sportive që të futet në Listën e Planeve Buxhetore për vitin e ardhshëm duke pasur gjithmonë në parallogari buxhetin i cili do të transferohet në Drejtorinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.
--	--	--	------------	---

	Furnizimi me ujë të pijes në qendër. Çështje tjetër parkingu në qendër ku është planifikua sheshi, kërkoj me u integrua edhe një parking.	Habib Mulaj, qytetar nga Drenasi:	E pranuar	Drejtoria e Infrastrukturës Publike : Ujësjetllësi Rajonal Prishtina –Njësia në Drenas është ajo që menaxhon me ujë të pijes dhe e cila grumbullon taksat nga ky shërbim. Komuna ka krijuar hapësira të mjaftueshme për vend parkingje brenda qyteti.
	Kërkoj që në lagjen e tyre të asfaltohet rruga.	Sabrije Berisha, banore e fshatit Shtuticë:	E pranuar	Drejtoria e Infrastrukturës Publike : Gjatë viti 2024-2025 janë planifikuar të përfundohen të gjitha rrugica aty ku pronësia e rrugës është publike.

Komuna e Drenasit,
25.09.2023

Përpiluar nga:
Liridona Fejza Ajazi
Udhëheqëse në Zyrtë Kuvendit Komunal

